



PRISHTINA

Republika e Kosovës

N.P.L "Stacioni Autobusëve
Prishtinë" sh.a



NPL "STACIONI I AUTOBUSEVE" SH.A. PRISHTINE
GJP "AUTOBUSKA STANICA" A.D. PRISTINA
MPE "BUS STATION" J.S. PRISTINA

	NPL "STACIONI I AUTOBUSEVE" SH.A. GJP "AUTOBUSKA STANICA" A.D. MPE "BUS STATION" J.S.
Nr. <u>02/515</u> No.	Data <u>14.04.2022</u> Date
PRISHTINE/A	

Raporti Vjetorë i Punës 2021

Prill 2022

NPL "Stacioni i Autobusëve" Sh.A. Prishtinë

MPE "Bus Station" J.S. Prishtina

Rr. Bill Clinton p.n., 10000 Pristine, Republika e Kosoves T: + 383 (0) 38 550 123 www.sap-rks.com info@sap-rks.com

Përmbajtja e dokumentit

1	Informata të përgjithshme	3
2	Përmbledhje ekzekutive	4
3	Prezantimi	5
4	Pasqyra e strukturës organizative e ndërmarrjes	5
4.1.	Informacion i përgjithshëm lidhur me burimet njerëzore në ndërmarrje	5
	Burimet njerëzore	7
5	Financat	9
5.1.	Të hyrat	9
5.2.	Shpenzimet Kategoritë e shpenzimeve	10
5.3.	Shpenzimet për paga dhe mëditje	10
5.4.	Shpenzime operative	11
5.5.	Shpenzime Administrative	14
5.6.	Shpenzimet e amortizimit	17
5.7.	Fitimi (Humbja) para fitimit	17
6	Çështjet juridike	17
7	Detyrimet kontigjentë	18
8	Transaksionet	20
9	Shërbimi i Transportit dhe Shërbimi Teknik	20
9.1.	Shërbimi i transportit	20
9.2.	9.2. Shërbimi Teknik	22
10	Shërbimi i sigurimit fizik aseteve dhe i laurave	23
11	Prokurimi	24
12	Digjitalizimi dhe TI-ja	24
13	Marrëdhëniet me publikun	27
14	Çështje të ndryshme:	28
15	Zyrtare për Marketing dhe Shitje	29
16	Zyra për Marrëdhënie me Klient	31
17	Të arriturat në bazë të objektivave dhe planifikimet	31
18	Auditimi	33
19	Auditimi i Jashtëm	33
	Shtojca 1: Organogrami	34
	Shtojca 2: Kontratat e prokurimit 2021	34

1 Informata të përgjithshme

Emri i ndërmarrjes:	NPL "Stacioni i Autobusëve" sh.a. Prishtinë
Shkurtesa:	SAP
Pronar:	Kuvendi Komunal i Prishtinës
Komisioni i aksionarëve:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Muhedin Nushi 2. Rifat Deri 3. Mirsad Vitia
Bordi i drejtoreve:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Faton Raci - Kryesues 2. Anita Morina Saraci - Anëtarë 3. Aferdita Syla Ismajli - Anëtarë 4. Fatmir Miftari - Anëtarë 5. Arianit Grezda - U.DKryeshef Ekzekutiv
Kapitali i ndërmarrjes:	11,542,209 €
Hapësira/ha:	8.24 ha
Numri i peronave:	24
Numri i hapësirave afariste:	33
Buxheti i planifikuar për 2021:	1,047,776.53€
Te hyrat për vitin 2021:	981,984.00 €
Shpenzimet për vitin 2020	958,494.00€
Racio e shpenzimeve:	Paga: 84% Kosto operative dhe administrative: 8% Kosto e Amortizimit 8%
Numri i punëtoreve:	85
Mosha mesatare:	45.21
Balanci gjinor:	60 meshkuj / 25 femra.
Ueb & domain	www.sap-rks.com

2 Përmbledhje ekzekutive

NPL "Stacioni i Autobusëve" sh.a. Prishtinë është ndërmarrje publike komunale e cila me shërbimet e ofruara ka rendësi të posaçme, që përpos që bënë lidhjen e kryeqytetit të vendit tonë me pika të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare, paraqet edhe një pasqyrë të rëndësishme jo vetëm të qytetit të Prishtinës por edhe të Republikës së Kosovës në të gjitha aspektet duke filluar atë kulturor, funksional etj.

Bazuar në skemën organizative gjatë vitit 2021 kanë qenë të punësuar 85 punëtorë, prej tyre 60 meshkuj dhe 25 femra me një moshe mesatare prej 45.21 vitesh. Struktura organizative e ndërmarrjes është e ndare në tetë (8), departamente-sektorë.

Ndërmarrja realizon të hyra vetanake dhe nuk varet nga buxheti komunal. Burimet kryesore të të hyrave janë, shërbimi i peronizimit (pranimi dhe përcjellja e autobusëve), shërbimi i shitjes së biletave të udhëtimit për operatorët e transportit rrugorë të udhëtarëve, shërbimi i ruajtjes së bagazhit të udhëtarëve, shërbimi i parkingut për automjete, shërbimi i poligoneve për auto shkolla, qiradhënia e lokaleve afaristë në pronësi të Stacionit të Autobusëve Prishtinë.

Në total gjatë vitit janë krijuar 981,984€ të hyra, që në krahasim me vitin paraprak janë 23% më shumë se viti paraprak.

Shpenzimeve e përgjithshme kanë qenë 958,494€ . Shpenzime të pagave 809,484€ apo 3%, më të larta se viti paraprak. Shpenzimeve operative 13% më të ulëta se 2020, dhe ato administrative në mase prej 26% më të ulëta se viti 2020.

Gjatë vitit të kaluar, Zyra e Prokurimit ka zhvilluar gjithëej 25 procedura dhe aktivitete të prokurimit, me vlerë të përgjithshme prej 39,059.87€. Prej tyre ishin dhjetë aktivitete me vlera minimale, në shumën totale prej 3,631.43€ pesëmbëdhjetë me vlera të vogla, në vlerë të përgjithshme prej 23,668.44€ dhe një (1) me vlerë të mesme, me vlerë të përgjithshme prej 11,760.00€

Gjatë vitit 2021, ndërmarrja ka operuar me një fitim prej 23,490.00€. Zhvlerësimit që paraqitet në shumë prej 74,616.45€, ndërsa nëse llogaritët vetëm shpenzimet dhe të hyrat operacionale kemi fitim prej 98,106.00€.

Viti 2021 është viti i parë që operojmë me fitim të vitit prej 23,490.00€.

Për periudhën vjetore të vitit 2021 janë realizuar gjithësej 119,817 nisje prej të cilave 100,310 ndërurbanë apo 15% më shumë se viti 2020 ,18,195 ndërkombëtarë apo 27% më shumë se viti 2020 dhe 1,312 sezonale.

3 Prezantimi

Ky raport vjetor bazohet në Ligjin mbi ndërmarrjet publike nr. 03-L-087, nenin 31, pika 31.3, ku qartë përshkruhet se, brenda 45 ditëve pas përfundimit të çdo viti kalendarik, Zyrtarët e NP-ve, në përputhje me Nenin 14.1, do të përgatisin dhe dorëzojnë Bordit të Drejtorëve të NP-së, një raport vjetor për vitin kalendarik të sapo përfunduar, në të cilin përshkruhen veprimet e marra, rezultatet financiare të arritura si dhe efektshmeria e përgjithshme në realizimin e caqeve të vendosura në Planin e Biznesit.

Prandaj bazuar në detyrimet dhe përgjegjshmëritë të cilat rrjedhin nga ligji mbi ndërmarrjet publike ky raport prezanton në mënyrë të qartë të gjitha veprimet e ndërmarra nga ana e menaxhmentit të ndërmarrjes në realizimin e objektivave të parashtruara gjatë vitit të kaluar, respektivisht vitit 2021.

Ky raport do të prezantojë strukturën organizative të ndërmarrjes, e cila pjesë paraqet pjesën më të vlefshme të ndërmarrjes, ku dihet që, burimet njerëzore janë aset i kryesor i çdo ndërmarrjes, sepse pa këto burime shumë vështirë do të mund të realizohen të gjitha synimet e planifikuara respektivisht, objektivat e planifikuara me qëllim që ndërmarrja të ketë suksesin e synuar.

Performanca afaristë dhe financiare e ndërmarrjes janë dy parakushtet kryesore lidhur me suksesin e gjithmbarshëm të ndërmarrjes. Prandaj edhe kjo pjesë do të paraqitet në mënyrë të detajuar lidhur me të gjitha informacionet sa i përket të hyrave, shpenzimeve dhe bilancin përfundimtar të sukses gjatë vitit 2021.

Çështjet juridike kanë rëndësi të veçantë për ndërmarrjen, si rrjedhojë të njëjtat kanë ndikim të madhë në suksesin e ndërmarrjes prandaj, do të behet prezantimi i të gjitha veprimeve të ndërmarra që ndërmarrja të operojë në nje ambient sa më të mirë të punës duke u bazuar në ligjet dhe rregulloret në fuqi.

4 Pasqyra e strukturës organizative e ndërmarrjes

4.1. Informacion i përgjithshëm lidhur me burimet njerëzore në ndërmarrje

NPL "Stacioni i Autobusëve" sh.a. Prishtinë, ka Bordin Drejtues (BD), në kuadër të të cilit vepron edhe Komisioni i Auditimit të zgjedhur nga komuna e Prishtinës, e cila është aksionar i ndërmarrjes, Kryeshefin Ekzekutiv (KE), Sekretarin, Zyrtarin Kryesore Financiar dhe të Thesarit (ZKFTH) të zgjedhur nga BD-ja si dhe Zyrtarin e Auditimit të Brendshëm (ZAB) të zgjedhur nga komisioni i auditimit.

Bazuar në skemën organizative gjatë vitit 2021 kane qenë të punësuar 85 punëtorë, prej tyre, 60 meshkuj dhe 25 femra me një moshe mesatare prej 45.21 vitesh.

Bazuar në Rregulloren për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës, të datës 17.05.2019, me numër protokollit 02/693, struktura organizative e ndërmarrjes është e ndare në tetë (8), departamente- sektorë:

1. Stafi mbështetës i KE-se;
2. Departamenti Administrativo – Juridik;

3. Departamenti ekonomik – financiar, i përberë nga shërbimi i kontabilitetit dhe shërbimi financiar – pagesave;
4. Zyra e Prokurimit;
5. Departamenti i Transportit dhe Shërbimit Teknik i përberë nga shërbimi i Transportit dhe Shërbimi teknik;
6. Sektori i digjitalizimit dhe TI-së
7. Sektori i Marketingut dhe Shitjes
8. Zyra për Marrëdhënie me Publikun

Struktura organizative e ndërmarrjes – organogrami është paraqitur ne shtojcën nr 1.

Burimet njerezore

- Procedura e rekrutimit

Përgjate muajit janar 2021 sipas konkursit të brendshëm të shpallur është zhvilluar procedura e rekrutimit të brendshëm për dy pozita të punës: Kordinator Nderrimi dhe Punëtor në mirëmbajtjen të objekteve dhe aseteve. Ku pas perfundimit të tërë procedurës së përzgjedhjes-rekrutimit sipas udhëzimit administrative (MPMS) nr.07/2017, u përzgjedhën kandidatet më të suksesshëm.

Përgjate muajit maj 2021 është shpallur konkursi i brendshëm të brendshëm për tre pozita të punës: Kordinator Nderrimi(1 vend pune), Kordinator I sektorit teknik (1 vend pune) si dhe Biletar (2 vende pune). Mirëpo për shkaqe teknike-administrative i njëjti është anuluar.

Përgjate muajit korrik 2021 është shpallur konkursi i brendshëm për këto pozita të punës: Kordinator Nderrimi(1 vend pune), Biletar (2 vende pune), Kontrolla Financiare (1 vend pune), Receptoniste (1 vend pune), Punëtor në sigurim (1 vend pune), Sigurim në Administratë (1 vend pune), Kordinator I sektorit teknik (1vend pune).Pas perfundimit të të gjitha procedurave të përzgjedhjes, kandidatet më të suksesshëm u sistemua në pozitave të tyre të reja të punës.

Përgjate muajit shtator 2021 është shpallur konkursi i brendshëm për dy pozita të punës: Kordinator Nderrimi(1 vend pune), Punëtor i sigurimit në laura. Mirëpo për shkaqe teknike- administrative i njëjti është anuluar.

Poashtu përgjate këtij viti është bërë edhe fusionimi i pozitave të punës: Vozitës I KE dhe Punonjes I Logjistikes në pozitave të punës: Vozites dhe logjistike.

- Pensionimet

Pensionet sipas bazës ligjore. Pensionim me arritjen e moshës së pensionimit prej gjashtëdhjetë e pesë(65) viteve sipas bazës ligjore Ligjit të punës LIGJI Nr. 03/L-212 përgjate vitit 2021 janë pensionuar katër punëtorë nga pozitave të punës: Dispicer (prill), Kordinator i sektorit teknik(maj) , Biletare (gusht) si dhe Kontrollë Financiare(shtator).

Pensionimet e parakohshme. Pas kërkesës së tyre personale dy punëtorë kanë shkuar në pension të parakohshëm sipas dispozitave të rregullores së brendshme Rregullore për pensionim të parakohshëm për punonjësit e NPL"Stacioni I Autobusëve" sh.a nr.02/1916 dt: 01.11.2019, e cila e rregullon këtë çështje.

Në muajin korrik ka shkuar në pension me kushtete veqante punëtori nga pozita Udheheqesi I Kontabilitetit. Ndërsa nga muaji shtator punëtorja nga pozita Likuidatore.

- Pushimet

Realizimi i pushimeve vejtore: Gjatë këtij viti të gjitha pushimet vjetore janë realizuar sipas kërkesave të punëtorëve dhe aprovimit dhe planifikimit të mbiqkyrësve të tyre në bashkpunim me zyren tone. Nga 91 punëtorë sa ka numeruar Nderrmarrja në fillimvit pothuajse të gjithë punëtorët kanë realizuar pjesën e parë të pushimit vjetore për vitin 2021, ndërsa tre punëtorëve l'u është aprovuar kërkuarsa që pjesën prej dhjetë ditësh pa shkëputje të e shfrytëzojnë në vitin 2022.

Shfrytëzimi i pushimit mjeksor: Nga 91 punëtorë sa ka numruar ndërmarrja në

fillimvit pushimin mjekesore të lejuar sipas ligjit të punës (deri ne 20 dite pune)e kanë shrytëzuar gjithsejt 55 punëtor. Ndërsa kuoten e ditëve të lejuara sipas ligjit të punës deri ne 20 ditë e kanë tejkaluar tre punëtorë.

Pushim pa pagesë: Përgjatë vitit 2021, pas kërkeses së tyre l'u është aprovuar pushimi pa pagese tre punëtorëve(Punëtor në laura x2, si dhe Punëtor në informatë x1)

Pushimi I Lehonisë: Përgjatë vitit 2021 konkretisht në muajin shtatorë një punëtorë ka shkuar ne pushim të lehonisë(Asistente e udheheqesit te zyres per marredhenie me publikun) ndërsa një punëtorë(Zyrtares e sistemit te dixhitalizimit) e cila ka qenë në pushim të lehonisë nga viti 2020 është rikhyer në punë në muaji nëntorë.

- **Moprezenca e puntorëve në punë për shkak të pandemise Covid-19.**

Për shkak të situates së krijuar për shkak të pandemisë globale Covid-19, ndërmarja jonë ka qenë vigjilente duke i ndermarre të gjitha veprimet e duhura sipas vendimeve te Qeverise se vendit.

Krahas vendimeve të Qeverisë së vendit edhe Ndërmarrja jonë në mënyrë të vazhdueshme ka nxjerr vendime për nevoja të brendshme si për lirim nga mosprezenca në punë për puntorët të cilët vuajn nga sëmundjet kronike gjithmonë sipas listës së përcaktuar dhe të publikuar nga Ministria e Shëndetësisë së Republikës së Kosovës,e poashtu edhe përcaktimin e stafit të nevojshëm punues (esencial) gjithmonë duke e pas prioritet shëndetin e puntorëve të Ndërmarrjes.

Nga baza e të dhënave nga zyra e burimeve njerëzore përgjatë vitit 2021, nga 91 punëtorë sa numruar Ndërmarrja ne vitin 2021, gjithsejt të prekur me virusin covid -19 kanë qenë 13 punëtorë, ndërsa sipas Manualit të publikuar nga Ministria e shëndetesisë persona kontakti kanë qenë 14 punëtorë.

Poashtu në hap me ndryshimet e vendimeve si dhe sipas kërkeses së Qeverisë së vendit vetëm pesë nga punëtorët e Ndërmarrjes nuk janë vaksinuar.

- **Përlllogaritja e stazhit të punës 0.5%.**

Në fillim të mujit janar të viti nga Menaxhmenti I Ndërmarrjes është marr vendim që stazhi i punës të përlllogaritet për të gjithë punëtorët e ndërmarrjes sipas të dhënave se në cilin muaj kanë krijuar marrdhënien e punës në ndërmarrje për dallim nga vitet e tjera ku gjithmonë stazhi i punës është përlllogaritur në fillim të vitit kalendarik, gjegjësisht në muajin janar.

- **Vlersimi i performances**

Procesi i vlersimit të rezultateve në punë (performances) së punëtorëve për vitin 2020 nga ana e mbikqyrësve të drejpterdrejt është finalizuar në muajin janar të këtij viti. Nota mesatare e vlersimit në nivel të ndërmarrjes për punëtorët e Ndërmarrjes është: 3.68.

- **Masa disiplinore.**

Përgjatë vitit 2021 duke u bazuar ne rregulloren e brendshme Rregullore për përgjegjësinë disiplinore nr.02/1160 dt:22.07.2019, janë shqiptuar masat disiplinore si në vijim: Tre masa vërejtëje me goje, tre masa vërejtje me shkrim, dy masa degradim , katër masa nderprerje e perkohshme e marrdhenies se punës (suspendim) si dhe dy nderprerje te marrdhenies se punes.

5 Financat

NPL "Stacioni i Autobusëve" sh.a Prishtinë, krijon të hyrat nga shërbimet e ndryshme të ofruara me statutin e ndërmarrjes, dhe ne këtë mënyre nuk shpenzon mjete nga buxheti i konsoliduar i Komunës së Prishtinës.

Shërbimet kryesore nga të cilat krijohen të hyrat e ndërmarrjes janë si ne vijim:

- Shërbimi i peronizimit – ky shërbim paguhet nga të gjithë auto transportuesit e regjistruar në Kosovë të cilët kanë linja të regjistruara dhe të lejuara nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës (MTI), për linjat nder-urbane dhe ndërkombëtare. Cmimorja për këtë shërbim caktohet nga Bordi i Drejtorëve të ndërmarrjes në marrëveshje me shoqatën e autotransporteve të Kosovës dhe me miratim të departamentit përgjegjës në kuadër të MTI-së.
- Shërbimi i parkingut – Ndërmarrja posedon një hapësirë e cila shfrytëzohet për parking të veturave privatë si dhe autobusëve të ndryshëm.
- Shërbimi i shitjes së biletave – Në marrëveshje me auto transportuesit, ndërmarrja bën shitjen e biletave për linja të ndryshme dhe me këtë rast krijon të hyra përmes shërbimit të shitjes së biletës si dhe provizionit për shitjen e biletës.
- Shërbimi i gardërobës – ndërmarrja ofron shërbimin e ruajtjes së bagazhit dhe në këtë mënyre krijon të hyra për këtë shërbim.
- Shërbimi i marketingut – ndërmarrja ofron shërbimin e reklamimit për operatorët e ndryshëm ekonomik për reklamimin e bizneseve të tyre, përmes hapësirave reklamuese si dhe reklamimin në ueb faqen e ndërmarrjes.
- Lëshimi i hapësirave afaristë me qira – ndërmarrja në kuadër të hapësirës së saj posedon 29 lokale të cilat i lëshon me qira në baze vjetore dhe nga të cilat krijon të hyra të vazhdueshme mujore.

Me qëllim që ndërmarrja të jetë funksionale ka kosto - shpenzime lidhur me paga dhe mëditje për punëtorë, përfshirë dhe shpenzimet për paga dhe mëditje për anëtarët e bordit si dhe zyrtarët e lartë të ndërmarrjes. Gjithashtu, janë të evidentuara edhe shpenzimet operacionale dhe ato administrative si dhe shpenzimet e amortizimit të

ndërtesës së ndërmarrjes dhe pajisjeve të ndryshme me të cilat funksionon ndërmarrja.

5.1. Të hyrat

54% e të gjitha të hyrave të ndërmarrjes krijohen nga shërbimi i peronizimit. Pra këto të hyra krijohen nga shërbimi i peronizimit i cili paraqet shërbimin kryesor në krijimin e të hyrave të ndërmarrjes të hyra këto që mundësohen përmes operimit të 231 auto transportuesve të ndryshëm të cilët i mbajnë linjat e ndryshme, si ato nder urbanë (linja lokale) njashtu edhe ato ndërkombëtare.

Të hyra tjera me rëndësi, janë edhe të hyrat nga qiratë të cilat paraqesin në total 19% e të gjitha të hyrave totale. Këto të hyra nga qiraja, realizohen nga bizneset dhe aktivitetet e tyre biznesore që zhvillohen në hapësirën e ndërmarrjes.

Një pjesë e hapësirës së stacionit shfrytëzohet për parking me pagesë, i cili shërbim paraqet një të hyrë të rëndësishme gjithashtu për ndërmarrjen. Gjatë vitit kjo e hyrë paraqet 23% e totalit të hyrave.

Janë edhe shërbimet tjera p.sh shitja e biletave, shërbimi i gardërobës, shërbimi i marketingut të cilat së bashku paraqesin rreth 4% në totalin e të hyrave. Kjo përqindje e vogël në të hyrat totale është si pasojë e kufizimeve të ndryshme të lëvizjes si pasojë e situatës pandemiologjike në vend gjatë vitit të kaluar.

Duke analizuar të hyrat me vitin paraprak kemi rritje prej 25% tek të hyrat apo janë duke mos përfshirë subvencionin e vitit 2020 dhe kemi gjeneruar 148,011.01€ më shume në krahasim me vitin e kaluar.

Të hyrat e realizuara nga këto aktivitete të ndërmarrjes janë të paraqitura në tabelën vijuese:

1- Të hyrat

Përshkrimi	2021	2020
Shërbimi i peronizimit	532,604.35	395,721.24
Shërbimi nga shitja e biletave	7,419.32	6,792.23
Komisioni nga shitja e biletave	136,053.81	19,015.21
Shërbimi i parkingut	227,657.77	136,031.89
Shërbimi i ruajtjes se valixheve (gardëroba)	6.77	-
Qiratë nga lokalet	191,111.49	192,984.07
Te hyra nga marketingu	2,563.55	1,398.30
Te hyra tjera (p.sh shitja e aseteve jashtë përdorimit)	8.40	3,647.86
Te hyra nga subvencionet		160,000.00
Totali I te hyrave Euro	1,097,425.46	915,590.80

5.2. Shpenzimet Kategoritë e shpenzimeve

Shpenzimet e përgjithshme janë të ndara në kategorinë e shpenzimeve për paga dhe mëditje, shpenzimeve operative, shpenzimet administrative dhe shpenzime të dedikuara për investime të nevojshme të cilat janë të domosdoshme për operacionet e ndërmarrjes.

5.3. Shpenzimet për paga dhe mëditje

Sa i perket shpenzimeve lidhur me paga dhe meditje në kuadër të ndërmarrjes njihen këto katëgori: kompensimi për anëtarët e bordt të drejtorëve, kompensim për aksionarët sipas Vendimit të K.K Komunes, pagat dhe mëditjet për punëtorët e ndërmarrjes përfshirë edhe zyrtarët e lartë, si dhe pagat përcjellëse shtesë të cilat

punëtorët i marrin pasi që të përmbushet kushti për pensionim të tyre sipas ligjit në fuqi.

Kompensimi për anëtarët e bordit bëhet sipas vendimit të aksionarëve ndërsa punëtorët tjerë paguhen në bazë të kontratave të punës valide të tyre sipas të cilave bëhet llogaritja e pagës. Përveç pagës bazë, punëtorëve aktiv iu shtohet shujta, në vlerë prej 3€ për çdo ditë pune dhe përvoja e vitëve të punësimit në bazë vjetore ku bëhet përlllogaritja nga 0.5% mbi pagën bazë, për çdo vit të punës. Punëtorët të cilët punojnë gjatë ndërrimit të natës dhe ditëve të vikendit i bëhet përlllogaritja 30% shtesë, si dhe për ditët e punës gjatë festave zyrtare të Republikës së Kosovës përlllogaritën prej 50% shtesë sipas Ligjit të Punës.

Krahasuar me vitin paraprak rritje prej 3% sa i perket këtyre shpenzimeve. Kjo rritje është bërë nga mos pagesës së shujtës në vitin 2020 për një periudhë të caktuar kohore për shkak të evitimit të mundshëm të mungesës së likuiditetit financiar të ndërmarrjes, si pasojë e situatës pandemike në vend, ku me të cilin rast ndërmarrja nuk ka qenë operacionale për rreth 3 muaj si dhe përë pjesën tjetër të periudhës së vitit nuk ka funksionuar me kapacitet të plotë për shkak të masave të qeverisë, respektivisht kufizimeve të ndryshme të ndodhura si shkak i pandemisë.

Shpenzimet e pagave bruto

2.1 Pagat	2021	2020
Bordi	27,179.90	31,789.44
Zyrtaret e larte	44,821.24	-
Administrata/Operativa	727,576.80	756,809.86
Pagat Jubilare	-	-
	9,906.04	-
Totali I pagave	809,483.98	788,599.30

5.4. Shpenzime operative

Në shpenzimet operative bëjnë pjesë të gjitha shpenzimet që ndërlidhen me funksionalizimin e mirëfilltë të ndërmarrjes. Në këtë kategori bëjnë pjesë shpenzimet e rrymës, shpenzimet e ujit, shpenzimet e mirëmbajtjes, shpenzime për veturë zyrtare, shpenzime për mirëmbajtje, të energjisë elektrike si dhe shpenzime tjera të paraqitura detajisht në tabelën e mëposhtme.

Shpenzim operativ në vitin 2021 kane qenë edhe shpenzimet lidhur me operacionet e ndërmarrjes si mirëmbajtjen e sistemit të digjitalizimit, rrymës ujit mirëmbajtjes etj. Totali i përgjithshëm i shpenzimeve operative për vitin 2021 janë 53,183.53 krahasuar me vitin 2020 që ka qenë 71,864.

SHPENZIME OPERATIVE 2021/2020	Më 31 Dhjetor 2021	Më 31 Dhjetor 2020
SHPENZIME RRYMËS	14,548.87	23,674.08
SHPENZIME UJIT	4,756.12	1,337.67
SHPENZIME MIRËMBAJTEJE OBJEKTIT	49.92	935.53
SHPENZIMET E MBETURINAVE	1,826.42	1,686.87
SHPENZIMET E MIRËMBAJTJE SË ENERGJISË	1,879.24	1,022.41
SHPENZIME BANKARE DHE PROVIZIONE	799.22	419.55
SHPENZIMET E MIRËMBAJTJES SË VETURAVE ZYRTARE	663.77	1,091.39
SHPENZIMET E MIRËMBAJTJES SË PERONAVE	1,270.00	3,291.02
SHPENZIMIET E PROGRMAIT TE SISTEMIT DIGJITALIZIMIT	9,136.39	7,917.30
SHPENZIMET E MIRËMBAJTJES TË APARATAVE KUNDER ZJARRIT	80.51	65.00
Shpenz.e sherb.te mirmbajtj	148.31	-
Shp.e mater. tjetër (rezhis	2,729.94	-
Shpenz.regjistrim sigurim-T	236.20	-
Shpenzimet KASKO	499.94	-
Shpenz.matjes se rezist-tok	425.00	-
Shpenz.mirmbajtje telefonav	269.86	-
Shpenz.e shërbimit për past	3,007.30	-
Shpen.operative-(ad hoc)	1,197.69	-
Shpenz.Ekskurzionit punetor	797.50	-
Shpenz.mimrbajtje.rruges,pa	446.84	-
Shpenz.Vlersimi i Aseteve	677.97	-
Shpenz.per tatime	7,736.54	-

SHPENZIMET E PASTRIMIT EDHE HIGJENES	-	6,350.00
SHPENZIME ME 8% TVSH	-	22.82
SHPENZIMET PËR TAKSA RRUGORE	-	75.00
SHPENZIMET PËR TAKSA KOMUNALE	-	1,922.65
SHPENZIMET PËR FURNIZIM ME NXEMJE ELEKTRIKE	-	33.81
SHPENZIMET PËR VESHMBATHJE TE PUNËTORËVE	-	137.24
SHPENZIMET E MIRËMBAJTJES SË IT-së	-	741.80
SHPENZIME E PLINIT NË HOLL	-	83.90
SHPENZIMET PËR PUNË FIZIKE	-	570.00
SHPENZIMET E MIRËMBAJTJES SË DYERVE DHE DRITAREVE	-	381.73
SHPENZIMET E MIRËMBAJTJES SË HOLLIT	-	43.88
SHPENZIMET PËR TRANSPORT-TAXI	-	48.85
SHPENZIMET E MIRËMBAJTJES SE ENERGJIS ELEKTRIKE	-	12,321.31
BARTJA E MJETEVE NË BANK	-	1,077.10
SHPENZIMET E MIRËMBAJTJES SE LAURAVE	-	888.85
SHPENZIMET DHE BLERJET DERI NË 1000€	-	146.26
MIRËMBAJTJA E TELEFONAVE	-	3.00
SHPENZIMET E MATERIALIT	-	2,040.42
SHPENZIMET E MIRËMBAJTJES SË ARKAVE FISKALE	-	551.69
SHPENZIME VLERSIMI I KËNAQËSIS SË KONSUMATORIT	-	845.76
SHPENZIMET PËR PASTRIM KIMIMK	-	10.17
SHPENZIMET E MIRËMBAJTEJES SË GJENERATORIT	-	39.47
SHPENZIMET PËR MIRMBAJTE TË NXEMJES	-	4.00
SHPENZIMET PËR AHENG ME TRANSPORTUES SI	-	1,271.19

PARTNER AFARIST		
SHPENZIMET PAISJE PËR IT	-	813.00
	53,183.53	71,864.72

Duke e bërë krahasimin me vitin paraprak kemi ulje të shpenzimeve operative prej 25% apo 18,681.19€.

Kjo ulje e shpenzimeve është bërë përmes një menaxhimi shumë rigoroz, përmes kontrollës dhe monitorimit të vazhdueshëm të të gjitha shpenzimeve.

5.5. Shpenzime Administrative

Shpenzimet administrative i përkasin shpenzimeve që lidhen direkt me funksionalizimin administrativ të ndërmarrjes. Në këto shpenzime hyjnë shpenzimet lidhur me automjetin zyrtar, materialin për zyrë, shpenzime të reprezentacionit, mirëmbajtja e softërit financiar, shpenzime për perkthimin e pasqyrave financiare sipas kërkesës së ZKA-së etj.

Në kuadër të kësaj kategorie është bërë regjistrimi i një rasti gjyqësor, një kontest i vjetër i trashëguar nga menaxhmenti i kaluar si dhe shpenzimet administrative për pagesat gjyqësore për pagesat e pagave jubilarë të punëtorëve të ndërmarrjes sipas aktgjyqimeve të gjykatës kompetentë.

Në krahasim me vitin paraprak kemi rënie të këtyre shpenzimeve në vlerë prej 3,243 apo 13% më pak në krahasim me vitin paraprak.

Shpenzime Administrative 2021/2020	Më 31 dhjetor 2021	Më 31 dhjetor 2020
SHPENZIMET E MATERIALIT PER ZYRE	2,210.29	1,783.49
SHPENZIMET E REPREZENTACIONIT TE KE-S	2,278.61	1,926.29
SHPENZIMET E DERIVATEVE TE VETURES	925.20	739.08
SHPENZIMET PER UJË TË PIJES PER PUNTORET E NDERRMARRJES	618.22	437.29
SHPENZIMET E TELEFONISË MOBILE	2,183.40	1,184.06
SHPENZIMET E REKLAMAVE DHE MARKETINGUT	75.13	218.64
SHPENZIMET E TELEFONISË FIKSE	656.23	479.72

SHPENZIMET E INTERNETIT	606.78	610.17
SHPENZIMET E SANITARIS	67.37	803.34
SHPENZIMET E FOTOKOPJES-PRINTERIT	915.01	948.56
SHPENZIMET PER MJETE DEZINFEKTIE	153.39	488.79
SHPENZIMET PER DEZINFEKTIM TE HAPSIRAVE TE SAP	439.41	403.39
SHPENZIMET E MIRMBAJTJES SE PROGRAMIT BILANCIT	932.20	1,553.00
SHPENZIMET PER ANTARSI VJETORE PER KONTABILIST	280.00	152.54
SHPENZIMET FURINIZM ME PAISJE ELEKTRONIKE	304.24	164.32
SHPENZIMET PER PERMBARUES PRIVAT	490.00	1,454.17
SHPENZIMET PER DOMAIN HOSTIM TE ËEB FAQES EMAIL MIRMBAJTJA VJETORE	277.44	310.00
SHPENZIMET PER VENDIME GJYGJSORE	3,163.00	3,850.26
Vl.bl.mallit te shit. depo-	1,538.50	-
Furnizimi me material	264.57	-
Shpenimet e mirmb,Zerimit	80.51	-
Shpenzi.e transportit me Ta	21.30	-
Shpenz.Auditim i jashtem	1,483.05	-
Shpenz.adminitr.tjera(ad ho	1,246.45	-
SHPENZIME DERIVATEVE	-	821.95
SHPENZIMET PER SHPALLJE-GAZETA	-	1,710.00
SHPENZIMET PËR PËRKTHIME	-	424.78
SHPENZIMET PER BYFE TE NDERMARJES	-	190.68
SHPENZIMET PER FOTO TE PERBASHKET TE PUNTOREVE NPL SAP	-	95.00
Shpenzimet e Noterimit	-	17.00

Shpenzimet e Postave te shpejta	-	28.25
shpenzimet per tarifa gjyqsore	-	31.00
SHPENZIMET PER INTERNET	-	203.39
SHPENZIMET DHURATA PER PUNTOR TE SAP	-	280.02
SHPENZIMET E TELEFONIT IPKO	-	922.19
SHPENZIMET TEL FIKS 038	-	191.97
SHPENZIMET E TEL PER PUNTOR	-	246.06
KESHILLA PROFESIONALE	-	245.00
SHPENZIMET PER MASKA MBROJTESE		63.78
SHPENZIMET BLEREJE E LULAVE	-	1,181.46
SHPENZIMET PER MIRMBAJTJE E WEB FAQES VJETORE ZHVILLIMI	-	296.66
TOTALI I SHPENZIMEVE ADMINISTRATIVE 2021/2020	21,210.29	24,456.30

5.6. Shpenzimet e amortizimit

Shpenzimet e zhvlerësimit për vitin 2021 janë në vlerë prej 79,479.24€. Zhvlerësimi i pasurisë së ndërmarrjes bëhet konform ligjit mbi pasuritë joqarkulluese. Ndërmarrja bën tri lloje të zhvlerësimit: me 0 zero që zhvlerësohet toka, 5% klasi i I, që paraqitën ndërtësat dhe 20% klasi i II, që zhvlerësohen paisjet. Të gjitha asetët e zhvlerësuara kanë jetëgjatësi më të madhe se një vit.

SHPENZIMET E ZHVLERËSIMIT 2021/2020	Më 31 dhjetor 2021	Më 31 dhjetor 2020
SHPENZIMET E AMORTIZIMIT TE KLASIT I 5%	56,310.51	56,349.76
SHPENZIMET E AMORTIZIMIT TE KLASIT II 20%	18,305.94	23,129.47
TOTALI I SHPENZIMEVE TË ZHVLERËSIMIT 2021/2020	74,616.45	79,479.24

5.7. Fitimi (Humbja) para fitimit

Në vitin 2021, NPL "Stacioni i Autobuseve" sh.a Prishtine, ka operuar me një fitim prej 23,490 €. Ky është viti i parë që prej pasluftës që NPL Sap Sha operon me një fitim të vitit.

Të ardhurat /Shpenzimet gjithëpërfshirëse	2021	2020
Të ardhurat gjithëpërfshirëse	981,984.00	915,590.81
Shpenzimet gjithëpërfshirëse	-958,494.09	-964,399.55
Fitim / humbje e vitit	23,489.91	-48,808.74

6 Çështjet juridike

Procedurat e ndryshme gjyqësore dhe nga Inspektorati i Punës - Departamenti administrativo- juridik gjatë vitit 2021, ka bërë përcjelljen e të gjitha veprimeve dhe aktiviteteve në kuadër të ndërmarrjes me qëllim të krijimit të një ambienti sa më të mirë duke u bazuar në ligjet e aplikueshëm dhe rregulloret në fuqi.

Gjatë vitit 2021, Bordi i Drejtorëve ka marrë gjithsej 10 vendime ndërsa ish Kryeshefi Ekzekutiv ka marrë gjithsej 104 vendime për çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me organizmin e dhe funksionalizimin e ndërmarrjes ndërsa U.D.KE ka marrë 20 Vendime.

Gjatë vitit 2021, është miratuar Statuti i ndërmarrjes

Në Kuader të zyrës ligjore të SAP- gjatë vitit 2021 janë ndërmarr një sërë veprimesh procedurale lidhur me lëndet- kontestet gjyqësore të cilat ende janë në proces dhe të disa të cilat kanë marrë formën e zgjidhjes përfundimtare.

C.nr. 1236/18 - Lënda ka të bëjë me padinë e iniciuar nga paditësi Ylber Çitaku – Zyra Ligjore e SAP- ka marrë pjesë në seancën përgatitore e cila është mbajtur me datë 09.03.2021. Z L në lidhje me këtë lëndë me datë 10.03.2021 gjykatës i dërgon prova shtesë në lidhje me lëndën. Lënda është ende në proces.

C.nr. 1508/17 – Lënda ka të bëjë me padinë e iniciuar nga paditësi Ahmet Maxhuni – Padia e paditësit është refuzuar nga Gjykata Themelore. Pditësi ka ushtruar të drejten e ankesës ku dhe përmes përfaqësuesit të tij ushtron ankesë kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore. Z L me datë 11.10.2021 ka paraqitur përgjigje në ankesë.

C.nr.6054/21 Z L me datë 05.11.2021 ka pranuar Aktevendimin e Gjykatës Themelore me të cilin e detyron SAP të i paraqet pikëpamjet e veta si palë e paditur nga paditësi Naser Tasholli. Lidhur me këtë Z L me datë 11.11.2021 i drejtohet me shkresë gjykatës ku i kërkon që palës së paditur në këtë rast ti përcillen të gjitha shkrsat e lëndës, pasi që përveç aktvendimit të gjykatës Z L nuk ka pranuar asnjë shkresë tjetër të lëndës kështu që ende nuk i dimë pretendimet e paditësit lidhur me këte çështje. Z L ende nuk ka marr përgjigje lidhur me kërkesën e parashtua me datë 05.11.2021.

C.nr.2905/09 – Z L ka pranuar ftesën për pjesmarrje në seancë e cila është mbajtur me datë 07.12.2021. Lënda ka të bëjë me kthim të tokës dhe kompensim sipas padisë së inicuar nga Ibrahim Troshupa. Në këtë seancë ka marr pjesë përfaqësuesi i Komunës, Z L nuk posedon informacione shtesë lidhur me ecurinë e seances, shkresa tjera të lidhur me lëndën nuk kemi pranuar.

C.nr.8245/2021 – me datë 01.12.2021 Z L ka pranuar njoftimin për kundërshtarin e sigurimit sipas propozuesit të sigurimit Luan Hoti. Z L me datë 07.12.2021 paraqet Kundërshtimin lidhur me propozimin e masës së sigurisë. Lënda është ende në proces.

Zyra Ligjore gjatë vitit 2021 ka pranuar nga Gjykata e Apelit edhe dy Aktgjykime tjera përfundimtare Ac.nr.1192/20, Ac.nr. 5498/19. Këto aktgjykime lidhen me pagat jubilarë nga ish punonjësit e ndërmarrjes. (Mustafë Selimi dhe Elez Gashi) Z L. Aktgjykimet janë respektuar dhe ish punonjësve të ndërmarrjes i'u është bërë pagesa në tërsi sipas Aktgjykimeve të pranuar.

7 Detyrimet kontigjentë.

Gjatë vitit 2021, ndaj NPL "Stacioni i Autobuseve" sh.a. Prishtinë janë inicuar disa padi të ndryshme lidhur me kompensime dhe kthim në pozita të punës nga ish punëtorët si dhe nga punëtorët aktual të ndërmarrjes me të cilat rastë është ballafaquar ndërmarrja edhe gjatë vitit 2021. Ne bazë të informacioneve zyrtare vlera totale e detyrimeve kontigjentë është 10,000 euro.

Emri dhe kërkesa e paditësit	Veprimet procedurale të ndërmarrja nga Zyra Ligjore	Rasti gjendet në procedurë në shkallën e I-rë ose II-të apo është përfunduar	Vlera e kontestit

Ahmet Maxhuni, Kthim në pozitën e Zëvendës të KE-së.	Përgjigje në ankesë	Eshtë refuzuar padi e paditesit në shkallë të parë. Lënda është duke u trajtuar në Gjykatën e Apelit sipas ankesës së parashtruar nga paditësi.	Afërsisht 30.000€
Ibrahim Troshupa nga Prishtina Kthim i ngastrës kadastrale nr.7533 ose kompensim financiar	Veprimi i fundit, Përgjigje në padi me datë 13.09.2018 nga avokati i autorizuar	Është në procedurë, Shkalla e parë	
Sami Ahmeti, Kompensim të pages në vlerë prej 50%, gjatë kohës së suspendimit.	Veprimi i fundit, është parashtruar ankesë në Gj. Të Apelit.	Është aprovuar padia e paditësit nga shkalla e parë, është në procedurë në Gj. Të Apelit.	Afërsisht 4.500€
Mehrije Rexha, Kthim në pozitën e më parshme të punës .	Veprimi i fundit, është bërë përgjigje në padi.	Është në procedurë, Shkalla e parë.	Diferenca e pagës 183€ nga dt.04.07.2018
Adonis Shabani, Kthim në pozitën e Arkivistit dhe kompensim te pages 50%.	Veprimi i fundit, është bërë përgjigje në padi.	Është në procedurë, Shkalla e parë.	Kompensim i pages 50%, 6 muaj. Paga baze 610€.
Driton Hasani, Kthim në pozitën e mëparshme të punës Shef I Sigurimit dhe kom. e dif. në page.	Veprimi i fundit, është bërë përgjigje në padi.	Është në procedurë, Shkalla e parë.	1,000 €
Mustaf Dodaj, Kompensim i pagave jubilarë.		Eshtë refuzuar padi e paditësit në shkallë të parë. Rasti ndodhet në Gj. Të Apelit.	2.20 €

Ylber Çitaku Anulim vendimi, kthimi në vendin e punës	Veprimi i fundit, përgjigje në padi me 24.01.2019.	Me 09.03.2021 mbahet seanca e shqyrtimit kryesor	Kthimi ne vendin e punes.
Luan Hoti - propozim për masë të sigurisë dhe padi kundër vendimit për shkarkim nga pozita e KE	Kundërshtim ndaj propozimit të masës së sigurisë dhe përgjigje në padi.	Në procedurë, gjykata themelore	

8 Transaksionet

Gjatë vitit 2021, janë shënuar 34 transaksione të prokurimit për furnizim me shërbime dhe materiale të ndryshme për nevojat e ndërmarrjes duke respektuar ligjin dhe procedurat e prokurimit publik (LPP) ne vlere prej 39,059.87€.

Transaksionet me vlere me të lartë kane të bëjnë me shërbimet e digjitalizimit në vlerë prej € 11,760.00 €, Furnizim me Server dhe Konfigurim 4,990.00€

Po ashtu duhet të përmenden edhe transaksionet sa i përket shpenzimit të energjisë elektrike në vlerë prej 14,548.87, e cila është si pasoje e përdorimit të energjisë elektrike për nxehjen e hapësirave të ndërmarrjes.

9 Shërbimi i Transportit dhe Shërbimi Teknik

9.1. Shërbimi i transportit

Shërbimi i transportit ka për qëllim ofrimin e shërbimeve sa më cilësore për Operatorët Transportues që realizojnë nisjet ndërrurbane dhe atyre ndërkombëtare nga NPL Stacioni i Autobusëve Prishtinë.

